



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 03 gusht 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 29 korrik 2022, KPK/Nr. 847/2022, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

- I. Për plotësim me një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
 1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 2. Të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
 3. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit;
 4. Të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
 5. Të mos ketë filluar hetimi penal;
 6. Të ketë reputacion të lartë profesional;
 7. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo në nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

- III. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.
- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon të gjithë prokurorët e Shtetit që i plotësojnë kriteret e cekura në këtë konkur që të aplikojnë.
- V. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- VI. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 03 gusht 2022 deri më datë 17 gusht 2022.
- VII. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 406, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://eëë.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.